

I Të përgjithshme

1. Furnizimet, shërbimet dhe kuotimet tona do të ofrohen shprehimisht mbi bazën e kushteve vijuese. Përveçse kur parashikohet ndryshe, këto kushte zbatohen si të vlefshme në momentin kur kryhen porositë e ardhshme, edhe pse këto kushte nuk janë përsëritur shprehimisht në marrëveshje apo nuk citohen shprehimisht në të.

2. Këto kushte do të zbatohen në mënyrë ekskluzive. Blerësi nuk mund të kërkojë referimin tek termat e kushtet e tij të biznesit, pasi termat dhe kushtet në këtë dokument janë të vlefshme pa asnjë përjashtim.

3. Në çdo rast, marrëveshjet individuale mbizotërojnë mbi këto kushte. Një kontratë me shkrim apo konfirmim me shkrim është përcaktues për përmbajtjen e këtyre marrëveshjeve.

4. Me qëllim që të jenë të vlefshme, deklaratimet dhe njoftimet ligjore ndaj nesh (psh. përcaktimi i afateve, ankesat për të defekte, tërheqje apo zvogëlime) pas lidhjes së kontratës duhet të bëhen në formë të shkruar.

5. Informacionet tona Teknike aktuale si edhe Rregullat e Teknologjisë përgjithësisht të njohura duhet të respektohen në lidhje me depozitimin, instalimin, montimin dhe përdorimin e produkteve.

6. Evidentojmë se çdo të dhënë lidhur me Blerësin dhe biznesin e kryer me të do të përpunohet nga ne sipas kuptimit të legjislationit për mbrojtjen e të dhënave personale.

II Kuotimet dhe lidhja e kontratës

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe, kuotimet tona nuk do të jenë detyruese. Shembujt dhe specimetet do të jenë vetëm për qëllime orientuese, pa asnjë lloj angazhimi nga ana jonë. Porosia përbën një ofertë detyruese për kontratë. Kontratat dhe marrëveshjet e shitjes do të bëhen detyruese vetëm nëse konfirmohen me shkrim nga ana jonë ose nëse dërgohet

porosia, me faturën tonë, dhe në rastin e fundit kjo zëvendëson konfirmimin me shkrim. Përveçse kur parashikohet ndryshe në porosi, ne kemi të drejtë të pranojmë ofertën për kontratë brenda katër javëve nga marrja e ofertës nga ana jonë.

2. Nëse ndonjë artikull i porositur nuk mund të dërgohet sepse furnizuesi ynë nuk na e ka furnizuar atë pavarësisht detyrimit kontraktor, jo për fajin tonë, ne kemi të drejtë të tërhiqemi nga kontrata me personin që ka dhënë porosinë pa asnjë lloj pasoje ndaj nesh dhe pala tjetër nuk ka asnjë të drejtë të kërkojë ndaj nesh dëme dhe/ose kosto eventuale. Në këtë rast, ne do t'ju informojmë pa vonesë se mallrat e porositura nuk janë më të disponueshme dhe do t'ju rimbursojmë pa vonesë për çdo përmbushje të kryer.

3. Kur jipet porosia, shprehja 'siç është furnizuar më parë' do ti referohet në çdo rast dizenjës dhe jo çmimit. I vetmi përshkrim i produktit i pranueshëm nga ana jonë do të jetë emri i artikullit REHAU. Referencat shtesë për emrat e artikujve të klientëve nuk do të jenë detyruese.

4. Çdo këshille teknike, verbale apo me shkrim, dhënë nga ne në lidhje me aplikimin nuk do të jetë detyruese – ashtu edhe në lidhje me të drejtat e pronësisë të palëve të treta – dhe nuk do të çlirojnë Blerësin nga kontrolli i produkteve tona në lidhje me përshtatshmërinë e tyre për proceset dhe qëllimet që ai dëshiron ti përdorë ato.

III Çmimet

1. Përveçse kur bihet dakort ndryshe, çmimet tona do të konsiderohen se janë çmime ex works ose çmime magazine dhe nuk do të përfshijnë paketimin, transportin ose TVSH-në e aplikueshme në ditën e dërgesës.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, çmimet në listat tona të çmimeve dhe në oferta do të jipen pa asnjë detyrim nga ana jonë dhe do të bazohen në faktorët aktualë të kostos. Nëse do të ketë ndonjë ndryshim në këto faktorë kostosh para datës së lidhjes së kontratës, psh. për shkak të rritjes së çmimeve të lëndëve të para

ose rritjes së kostos së punës, ne do të kemi të drejtën për të ndryshuar çmimet tona. Nëse periudha midis lidhjes së kontratës dhe datës së parashikuar të dërgimit është më shumë se tre muaj, ne kemi të drejtë të ndryshojmë çmimet tona sipas ndryshimeve të faktorit kosto, psh. në rast të rritjes së çmimeve të lëndëve të para ose rritjes së kostos së punës. Ne do të kontaktojmë blerësin në rast të një ndryshimi të tillë, kur çmimet rriten me më shumë se 5%; Blerësi ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata. Kjo duhet të deklarohet brenda një jave nga njoftimi ynë; përndryshe, çmimi i rritur konsiderohet i pranuar dhe duhet paguar.

3. Porositë për të cilat nuk është rënë dakort për çmimin do të faturohen me çmimet që janë në fuqi në datën e lidhjes së kontratës. Paragrafi i 2 më lart aplikohet në çdo aspekt.

4. Pëveçse kur bihet dakort ndryshe, çmimet e shitjes si edhe të gjitha kuotimet dhe kalkulimet do të bëhen me monedhën MKD. (në EURO për dërgesat në Shqipëri dhe Kosovë)

IV Termat e pagesës

1. Pëveçse kur bihet dakort për terma pagese të ndryshme me anë të një kontrate të mëvetshme, do të aplikohet një zbritje prej 2% mbi vlerën e mallrave (përfshirë kosto e paketimit, transportit dhe kosot të ngjashme) për pagesat brenda 10 ditëve, pagesa neto brenda 30 ditëve nga data e faturës, përveçse kur parashikohen kushte të tjera pagese në listën e çmimeve për produkte të veçanta. Nuk do të aplikohet asnjë zbritje në lidhje me kostot e punës. Zbritjet do të njihen me kusht që të gjitha pagesat në lidhje me dërgesat e mëparshme të jenë shlyer plotësisht. Pagesat duhen kryer pavarësisht njoftimeve për defekte. Vendi i përmbushjes së detyrimit lidhur me pagesën do të jetë në Shkup.

2. Pëveçse kur parashikohet ndryshe, do të pranohet që të mbahen apo kompesohen pagesa vetëm nëse pretendimi i blerësit është i pakontestueshëm apo është plotësisht i vlefshëm.

3. Në rast moskryerje pagese nga ana e blerësit, do të ekzekutohen të gjitha burimet e

llogarive dhe shumave parashikuar në premtim pagesat e personit që porositi dhe/ose dorëzanësit. Nëse termat e pagesës nuk respektohen apo në rast se rrethanat që ndodhin çënojnë besueshmërinë e Blerësit, ne do të kemi të drejtë të kërkojmë që të na paguhet e drejta jonë për arkëtim menjëherë dhe në mënyrë të plotë. Gjithashtu, ne do të kemi të drejtë kryejmë dërgesat e mbetura vetëm pas kryerjes së parapagimit ose dhënies së garancisë. Nëse paragimet nuk kryhen ose nëse nuk jipen garancitë, pas kalimit të një periudhe të përshtatshme ne do të kemi të drejtë të tërhiqemi nga kontrata në lidhje me shërbimet ose dërgesat e mbetura, dhe nuk do të kemi ndonjë detyrim në lidhje me këto dërgesa të cilat nuk janë kryer në momentin e zgjidhjes së kontratës.

4. Ne do të kemi të drejtë të kompensojmë të gjitha të drejtat për arkëtim që duhet të na paguhet nga Blerësi për shkaqe që lidhen me dërgesën apo për shkaqe të tjera ligjore.

V. Ruajtja e titullit të pronësisë dhe garanci të tjera

1. Ne do të ruajmë titullin e pronësisë mbi çdo mall derisa të kemi marrë pagesën e plotë nga ana e Blerësit, përfshirë çdo të drejtë tjetër për arkëtim që mund të lindë në të ardhmen nga marrëdhënia e biznesit.

2. Blerësi do të ketë të drejtë të procesojë dhe të shesë mallrat nën titullin e pronësisë gjatë aktivitetit normal të biznesit.

3. Blerësi na kalon ne si ganaci të gjitha të drejtat për arkëtim që duhet ti paguhet atij në lidhje me mallrat që janë subjekt i ruajtjes së titullit të pronësisë (pavarësisht arsyes ligjore të tyre, përfshirë të drejta nga rishitja, shumat për arkëtim nga marrëveshjet aktuale, çdo trajtim, procesim apo bashkim i këtyre mallrave të furnizuara prej nesh, përfshirë të drejta që burojnë nga përgjegjësia jashtëkontraktore, pretendime nga sigurimet). Në çdo rast cedimi do të kufizohet vetëm në vlerën e mallrave të furnizuara, siç tregohet në faturën tonë. Në rast se klienti i Blerësit e ka përjashtuar të drejtën e

cedimit të të drejtave të arkëtueshme, Blerësi dhe ne, benda marrëdhënies së biznesit, do të veprojmë sikur të drejtat e arkëtueshme të mësipërme të çdolloji të na jenë ceduar neve efektivisht. Ne do të autorizohemi nga Blerësi për të verifikuar shumën e të drejtave për arkëtim që do të na kalohet sapo blerësi to mos ketë më këtë të drejtë, në përputhje me parashikimet e mëposhtme, si edhe autorizohemi të marrim shumën në emrin e tij.

4. Ne në mënyrë të revokueshme autorizojmë Blerësin për të ekzekutuar, në emër të tij dhe për llogarinë tonë, të drejtat e arkëtueshme që na janë ceduar. Sapo Blerësi të mos ketë përmbushur ndonjë prej detyrimeve ndaj nesh apo në rast se kemi të bëjmë me ndonjë prej rrethanave të parashikuara në pikën IV.4, me kërkesën tonë, Blerësi do të bëjë publik cedimin dhe do të na pajisë me informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm. Gjithashtu ne do të kemi të drejtë për të njoftuar drejtpërsëdrejti debitorët e Blerësit për cedimin dhe për të kërkuar pagesën prej tyre.

5. Sapo të dorëzohen, mallrat nuk duhet të vendosen peng apo cedohen si garanci pa pëlqimin tonë. Në rast të veprimeve nga palët e treta që synojnë marrjen e mallrave nën titullin tonë të pronësisë, Blerësi do të evidentojë të drejtën tonë të pronësisë mbi to, dhe do të na informojë pa vonesë si edhe do të na ofrojë çdo lloj asistence që është e nevojshme për të ruajtur të drejtat tona.

6. Në rast se Blerësi vepron në shkelje të kontratës – në veçanti në rast se nuk kryhen pagesën – ne kemi të drejtë të ushtrojmë të drejtën tonë lidhur me titullin e pronësisë dhe të kërkojmë kthimin e menjëhershëm të mallrave nën regjimin e titullit të pronësisë në favorin tonë, si edhe të sigurojmë, vetë apo nëpërmjet agjentëve, posedimin e tyre direkt, ose nëse është e nevojshme, të kërkojmë cedimin e të drejtave të Blerësit për kthimin e mallrave nga palët e treta. Ushtrimi i së drejtës për ruajtjen e titullit të pronësisë nuk përfshin të drejtën për tu tërhequr nga kontrata.

7. Në rast se vlera e garancive në favorin tonë kalon të drejtat tona e arkëtueshme për më shumë se 10%, me kërkesën e Blerësit, do të

ndërmarrim çlirimin e garancive sipas vlerësimit tonë.

8. Blerësi do të sigurojë në mënyrë të përshtatshme të gjitha mallrat nën titullin tonë të pronësisë nga rreziqet nga zjarri dhe vjedhja. Çdo pretendim për dëme ndaj të siguruarve na cedohet në vlerën e mallrave që janë nën titullin tonë të pronësisë.

VI Afatet e dërgesës dhe përmbushjes së detyrimit

1. Vendi i përmbushjes së dërgesave do të jetë në Shkup ose në vendin e fabrikës apo magazinës e cila do të kryejë dërgesën. Përveçse kur parashikohet ndryshe, afati i dërgesës dhe përmbushjes së detyrimit do të jetë momenti kur malli është larguar nga fabrika ose kur është dhënë njoftimi se malli është gati për tu dërguar ose shërbimi është kryer.

2. Vendi i dërgesës dhe përmbushjes së detyrimit do të zgjatet me një afat të arsyeshëm në rast marrjes së masave si rezultat i veprimit industrial, në veçanti në rast grevash si edhe në rast të pengesave të paparashikueshme jashtë kontrollit tonë për aq kohë sa këto pengesa kanë një ndikim të rëndësishëm mbi prodhimin ose dërgimin e mallit për shitje ose ofrimin e shërbimit të kërkuar. Kjo do të aplikohet edhe në rast kur këto rrethana i ndodhin furnitorit tonë ose në rast se ne nuk jemi të furnizuar mjaftueshmërisht me lëndë të parë jo për fajin tonë ose në rast se këto rrethana shfaqen në rast mospërmbushje nga ana jonë. Në rast se afati zgjatet për një periudhë më të gjatë, – pas dhënies së një afati shtesë– ne dhe Blerësi do të kemi të drejtë të tërhiqemi nga kontrata. Në raste të rëndësishme ne do të njoftojmë Blerësin në momentin më të parë në të cilin shfaqen apo zhduken pengesat.

3. Dërgesat dhe shërbimet (përmbushja e kontratës) do të ofrohen me kusht që përmbushja të mos kufizohet nga rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht rregullat e kontrollit për eksport dhe embargot dhe ndonjë kufizim tjetër. Palët kontraktuese detyrohen të ofrojnë të gjithë informacionin dhe

dokumentacionin e nevojshëm për eksportin / importin e ngarkesës. Vonesat e shkaktuara nga kontrollet e eksportit ose procedurat e licensimit do të mbizotërojnë çdo afat të rënë dakort. Nëse ndonjë liçencë e kërkuar për ndonjë produkt nuk mund të merret, kontrata do të konsiderohet e palidhur në lidhje me zërat në fjalë për këtë shkak, dhe përjashtohet çdo pretendim për dëme.

4. Blerësi mund të anullopë kontratën pa dhënë njoftim nëse është e pamundur për ne të përmbushim të gjitha shërbimet e kontraktuara përpara kalimit të riskut. Gjithashtu, Blerësi mund të anullopë kontratën nëse provohet se është e pamundur për të përmbushur pjesë të porosisë dhe nëse ai ka interes të justifikuar në refuzimin e dërgesës pjesore. Nëse nuk është ky rasti, Blerësi duhet të paguajë pjesën e çmimit të kontratës që mbulon dërgesën pjesore. E njëjta gjë aplikohet edhe në rast pamundësie nga ana jonë. Seksioni IX zbatohet për rastet e tjera. Nëse pamundësia ndodh gjatë vonesës së lejuar, ose nëse Blerësi mban përgjegjësinë e vetme ose pjesën më të madhe të saj, ai mbetet i detyruar për të kryer pagesën.

5. Mospërmbushja përcaktohet nga rregullat në fuqi. Në çdo rast kërkohet njoftimi me shkrim nga ana e Blerësit. Nëse ne jemi mospërmbushës Blerësi ka të drejtë të kërkojë kompensimin nga mospërmbushja në formën e një shume fikse. Për çdo javë të plotë vonesë, kjo shumë do të jetë 0,5%, megjithatë në total nuk do të kalojë 5 % të vlerës së asaj pjese të dërgesës së përgjithshme, e cila rezulton me vonesë, dhe jo në përputhje me kontratën. Pretendimet e tjera që lidhen me dërgesën e vonuar rregullohen ekskluzivisht në përputhje me Seksionin IX të këtyre kushteve.

6. Mallrat e njoftuara se janë gati për tu dërguar do të merren menjëherë nga Blerësi me kalimin e afatit të dërgesës; përndryshe ne do të kemi të drejtë të dërgojmë mallrat sipas gjykimit tonë ose ti depozitojmë ato sipas diskrecionit tonë për llogari të Blerësit dhe me riskun e Blerësit. E njëjta gjë do të aplikohet në rast se dërgimi nuk mund të kryhet nga ne për shkaqe jashtë kontrollit tonë. Me njoftimin se mallrat janë gati

për dërgim, mallrat do të konsiderohen se janë furnizuar dhe mund të lëshohet faturë për to.

7. Mënyra e dërgimit, mjetet e transportit, rruga e transportit si edhe natyra dhe qëllimi i mjetit mbrojtës së nevojshëm, zgjedhja e dërguesit apo transportuesit si edhe ambalazhimi do të jetë në diskrecionin tonë. Kjo do të realizohet sipas gjykimit tonë si edhe me kujdes dhe vëmendje të duhur duke përjashtuar çdo lloj përgjegjësie. Mallrat do të sigurohen sipas kërkesës së shprehur të Blerësit dhe me shpenzimet e tij.

8. Dërgesat pjesore lejohen. Ne kemi të drejtë të kryejmë dërgesa me një sasi më të madhe ose më të vogël se deri në 10 % të sasisë së porositur dhe deri në 20% në rast të dizenjove speciale. Sasia e dërguar tarifohet.

VII Kalimi i riskut

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe, risku do të kalojë në çdo rast tek Blerësi kur mallrat transferohen tek dërguesi apo transportuesi, por në çdo rast kur ato largohen nga fabrika apo magazina.

2. Të gjitha ankesat në lidhje me dërgimin e mallrave jo në mënyrë të duhur, me defekte apo jo në sasinë e kërkuar duhet ti njoftohen Shitësit pa vonesë dhe në çdo rast brenda 10 ditëve nga marrja e mallrave. Në rast të kundërt dërgesat do të konsiderohen se janë pranuar.

VIII. Pretendimet lidhur me defektet

Në rast se mallrat e dërguara janë materialisht dhe ligjërish me defekt, ne ofrojmë garancitë vijuese, duke mos pranuar asnjë pretendim të mëtejshëm:

Defekte materiale

1. Riparim falas, sipas vlerësimit tonë, zëvendësim të të gjitha mallrave ose pjesë të tyre që rezultojnë me defekt brenda periudhës së skadencës, për aq kohë sa shkak ekzistonte para kalimit të riskut dhe me kusht që Blerësi të ketë kryer inspektimin e tij dhe të ketë

përbushur detyrimin për njoftim. Nëse Blerësi nuk përbush detyrimin për kryerjen e një inspektimi të duhur si dhe / ose nuk kryen njoftimin, ne përjashtohemi nga përgjegjësia për defektin që nuk jemi njoftuar.

2. Nëse një defekt bëhet shkak për paraqitjen e një pretendimi, Blerësi mund të mbajë një pjesë të pagesës e njëjtë me vlerën e defektit material. Blerësi mund të mbajë pagesën vetëm kur është e pamundur për tu dyshuar mbi vërtetësinë e njoftimit të defektit. Nëse pretendimi provohet të jetë i pabazë, ne kemi të drejtë të rikërkojmë kostot tona prej Blerësit.

3. Fillimisht, ne kemi të drejtë për të zëvendësuar mallin brenda një afati të arsyeshëm. Nëse zëvendësimi nuk kryhet, Blerësi mund të anulojë kontratën ose zvogëlojë pagesën.

4. Pretendimet për defekte nuk janë të pranueshme nëse produktet ndryshojnë në mënyrë të papërfillshme nga karakteristikat e rëna dakort, nëse përdorimi sipas qëllimit të tyre nuk çënohet mjaftueshëm, ose në rast se ato çvlerësohen apo dëmtohen pas kalimit të riskut për shkak të neglizhencës apo fajit, ose në rast se mbi to ushtrohet forcë ose përdoren me mjete jo të përshtatshme. Ne do të kemi të drejtë të mos pranojmë porosi nëse Blerësi nuk na dërgon pjesët me defekt brenda 4 javëve nga kërkesa, përveçse kur dërgesa e këtyre pjesëve nuk mund të realizohet për shkak të natyrës së saj apo mënyrës së instalimit, etj.

Defektet ligjore

5. Nëse ne duhet të dërgojmë mallra mbi bazën e vizatimeve, modeleve, shembujve apo pjesëve ekzemplare të ofruara nga Blerësi, ky i fundit mbarë detyrimin për të shmangur cdo shkelje të ndonjë të drejte të ndonjë palë të tretë në vendin në të cilin destinohen mallrat. Ne do të informojmë klientin për çfarëdolloj të drejte që kemi dijeni. Blerësi duhet të na çlirojë nga pretendimet e palëve të treta dhe të na kompensojë çdo dëm të shkaktuar. Nëse ndonjë palë e tretë na ndalon nga prodhimi ose dërgimi i mallave për shkak të të drejtave të pretenduar prej tij, ne kemi të drejtë – pa detyrimin për të verifikuar pozicionin ligjor – të

ndërpresim punën deri në sqarimin ligjor nga ana e Blerësit dhe e palës së tretë. Nëse vonesa është e tillë sa ne nuk mundet që në mënyrë të arsyeshme të përbushim kontratën, ne kemi të drejtë ta anulojmë atë.

6. Duke ndaluar çdo marrëveshje të kundërt, ne jemi të detyruar të dërgojmë vetëm brenda vendit që është vendi destinatar, të çliuar nga të drejta që lidhen me patenta industriale dhe të drejtat e autorit të zotëruara nga palë të treta. Nëse nga përdorimi i mallrave të dorëzuar çënohen të drejta që lidhen me patentat industriale apo të drejtat e autorit, në parim, me shpenzimet tona do të sigurojmë që Blerësi të vazhdojë ti përdorë ato, ose do të sigurojmë që mallrat e dorëzuara të mos çënojnë më tej të drejtat në fjalë duke i ndryshuar mallrat ashtu sic Blerësi pret në mënyrë të arsyeshme.

7. Nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë të arsyeshme tregtare, Blerësi ka të drejtë të anulojë kontratën. Në kushtet e sipërcituara, edhe ne kemi të drejtë të anulojmë kontratën.

8. Gjithashtu ne do të çlirojmë Blerësin nga pretendime të pakontestueshme ose ligjore prej zotëruesve të të drejtave mbrojtëse.

9. Detyrimet tona cituara në nr. 7– duke rezervuar Seksionin IX , - janë përfundimtare në rast shkelje patente apo të drejtash të autorit.

Ato ekzistojnë vetëm nëse

-Blerësi na ka informuar pa vonesë mbi pretendimet e regjistruara lidhur me shkeljet e patentave dhe të të drejtave të autorit,

- Blerësi na jep mbështetje të arsyeshme në kundërshtimin e pretendimeve të paraqitura ose na krijon mundësi që të kryejmë ndryshimet sipas nr. 5

- Ne na rezervohen të gjitha masat ligjore të mbrojtjes, përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë-gjyqësisht

- Defektet ligjore nuk lindin nga një udhëzim apo parashikim i posaçëm i Blerësit; dhe

- Blerësi nuk ka kryer shkeljen e ndonjë të drejte mbrojtëse duke ndryshuar qëllimisht objektin e dorëzuar, apo duke e përdorur atë në një mënyrë të paparashikuar në kontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër që passjell përgjegjësinë për shkeljen.

IX Përgjegjësia

1. Pretendimet e blerësit për dëme dhe kompensim kostosh të çdo natyre përjashtohen për aq kohë sa kushtet nuk parashikojnë ndryshe.

2. Në lidhje me detyrimin për informacion të REHAU sipas kushteve të Regullores (KE) Nr. 1907/2006 lidhur me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe kufizimin e Kimikateve (REACH) REHAU nuk do të jetë përgjegjës për tërësinë dhe saktësinë e informacionit të marrë prej furnizuesve të tij.

X. Parashkrimi

Të gjitha pretendimet e Blerësit – pavarësisht arsyeve ligjore të tyre – parashkruhen brenda 12 muajve, përveçse kur parashkrimi është për një afat më të shkurtër për ndonjë rast të veçantë.

XI. Toleranca

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në Standartet DIN, specifikimet e prodhimit ose standartet e tjera (psh. Specifikimet Teknike të dërgesës ose skicimet e REHAU) gjatësitë dhe profilet, me përjashtim të produkteve realizuar nga materiale sfungjeri, do të jenë subjekt i tolerancave vijuese:

-Për profilet, nëse janë të matshme: gjërësi, lartësi dhe diametër, DIN 16941 -3A, shumë e përafërt,

-Për dimensione speciale / tuba: zakonisht në përputhje me DIN 40621 "Tuba me mbrojtës B (pa insert tekstili)"

Diametri i brëndshëm: +-5%

Trashësia e murit: +-10%

-Për tuba të tjerë:

Diametër i brëndshëm: deri në 5 mm + 0,1/ - 0,2 mm

Mbi 5 deri në 8 mm + 0,2/- 0,3 mm

Mbi 8 mm +2,5%/-3%

Trashësia e murit: deri në 0,7 mm +0,1/- 0,1mm

Mbi 0,7 deri në 1,5 mm +0,15/-0,15 mm

Mbi 1,5 mm +- 10 %

Gjatësitë e prodhimit (përfshirë silikon) do të jenë subjekt i tolerancave lineare, të matura në temperaturë dhome menjëherë pas prodhimit. Profilet dhe tubat: në përputhje me DIN 16941 – 3A dhe DIN 2768 -1, spirale dhe rrotullime: +- 2%

Për tuba dhe profile të bëra prej silikon, do të aplikohet toleranca e formës sipas DIN ISO 3302 E 3.

2. Të dhënat mbi fortësinë A do të jenë subjekt i tolerancës në kufirin ± 3 për termoplastikat dhe ± 5 për elastomerët (përcaktuar duke përdorur njësitë e normuara). Ndryshimet tregtare normale në cilësi, peshë dhe ngjyrë nuk do të përbëjnë në asnjë mënyrë arsye për të refuzuar dërgesën. Ilustrimet, dimensionet dhe pesha e treguar në listat tona, Specifikimet teknike të Dërgesës, specifikimet e prodhimit, kuotimet dhe konfirmimet e porosisë do të jenë vetëm të dhëna të përafërta. Ndryshime në dimensione, peshë, numër njësisish dhe cilësi do të lejohen brenda qëllimit të tolerancës tregtare normale ose në përputhje me standartet përkatëse. Nuk do të prezumohet asnjë garanci për përputhshmëri.

3. Në të gjitha aspektet e tjera, përveçse kur parashikohet ndryshe apo udhëzohet ndryshe nga ne, tolerancat e lejuara janë sipas normave dhe udhëzimeve përkatëse (DIN, VDE , etj.).

XII Të drejtat e autorit dhe të drejtat e patentave industriale, modelet dhe pajisjet

1. Ne rezervojmë të drejtën e pronësisë dhe të drejtat e autorit mbi skicimet, ekzemplaret dhe informacione të tilla. Ato nuk duhet ti vihen në dispozicion ndonjë pale të tretë pa miratimin tonë.

2. Në të gjitha rastet, ne do të pretendojmë të drejtën ekskluzive të prodhimit për ato artikuj që lidhen me dizenjimet, skicimet dhe pajisjet e prodhuara prej nesh. Përveçse kur lejohet shprehimisht, nuk lejohet që të transferohet ose të riprodhohen këto dokumenta dhe pajisje, si edhe përmbajtja e këtyre dokumenta nuk do të bëhet publike apo të përdoren. Shkeljet pasjellin ushtrimin e së drejtës për shpërblim dëmi. Ne rezervojmë të gjitha të drejtat në rast shkelje të një patente të dhënë dhe për regjistrimin e dizenjosh. Blerësi do të garantojë se prodhimi dhe furnizimi i pajisjeve sipas të dhënave të Blerësit nuk shkelin të drejtat e pronësisë së ndonjë pale të tretë. Modelet, ekzemplarët dhe pajisjet e tjera do të mbeten pronësi vetëm e jona, edhe në rastin kur Blerësi faturohet me kostot ose shpenzimet e tyre.

3. Duke qenë se ne prodhojmë ose prokurojmë modele, forma, pajisje dhe mjete formuese për llogari të Blerësit, ne do të faturojmë veçmas pjesë të shpenzimeve që lidhen me to. Duke qenë se këto kosto pjesore nuk mbulojnë shpenzimet që përballojmë nga dizenjimi, ndërtimi, know-how, puna e operimit dhe e mirëmbajtjes, këto module, forma dhe pajisje si edhe mjete të tjera do mbeten pronë vetëm e jona. E njëjta gjë aplikohet për ndryshimet ose modelet zëvendësuese, pajisjeve dhe moduleve vijuese. Kostot e pajisjeve, moduleve, etj., do të paguhen bashkë me tatimin mbi vlerën e shtuar, me marrjen e faturës. Ne do të jemi përgjegjës vetëm për të mbajtur këto artikuj për një periudhë prej 3 vitesh pas datës së dërgesës së fundit.

XIII. Jurisdiksioni dhe çështjet e tjera

1. Gjykata Kryesore e Shkupit II, do të ketë juridiksion ekskluziv –edhe ndërkombëtar– për të gjitha pretendimet dhe detyrimet, pavarësisht vlerës së mosmarrëveshjes.

2. Nëse pala kontraktuese pezullon kryerjen e pagesës ose parqitet një kërkesë për paaftësi

paguese kundër asetëve të tij ose në lidhje me procedurat jashtë-gjyqësore, atëherë REHAU do të ketë të drejtë të tërhiqet nga kontrata për pjesën e papaguar.

3. Ligji i Maqedonisë do të jetë ligji i zbatueshëm. Përfshihet aplikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara datë 11.4.1980 në lidhje me kontratat për blerjen ndërkombëtare të mallrave.